

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: MIRËMBAJTJE E SISTEMIT VMS PËR MINISTRINË E
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 50324100-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 82,200,000 (tetëdhjetë e dy milion e dyqind mijë) lekë, pa TVSH ose 896,890.34 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e katër) Euro.
(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (91.65), datë 18.09.2026)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të TOR’s..

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
SSH/UNI/DIN/EN ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë, të sigurisë së informacionit, si sisteme të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit.

Standardi ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalent/i barasvlefshëm – Kërkesa për këtë standard lidhet me nevojën që operatori ekonomik të ketë të implementuar dhe funksional një sistem të menaxhimit të cilësisë, nëpërmjet të cilit sigurohet organizimi, kontrolli dhe monitorimi i proceseve që lidhen me realizimin e shërbimit objekt prokurimi.

Referuar natyrës së shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit VMS dhe nevojës për ruajtjen e vazhdimësisë së funksionimit të tij, zbatimi i këtij standardi siguron që proceset e monitorimit, diagnostikimit, konfigurimit, mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, si dhe trajtimit të incidenteve, të menaxhohen sipas procedurave të përcaktuara dhe të kontrolluara.

Implementimi i këtij standardi kontribuon në menaxhimin efektiv të burimeve, kontrollin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, evidentimin dhe trajtimin e problematikave, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve, duke mbështetur realizimin në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase të shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemit VMS.

Standardi SSH/UNI/DIN/EN ISO/IEC 27001 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, ose ekuivalent/i barasvlefshëm – Kërkesa për këtë standard lidhet me natyrën e sistemit VMS dhe nevojën për mbrojtjen e informacionit dhe të të dhënave që administrohen dhe përpunohen gjatë realizimit të shërbimit.

Mirëmbajtja e sistemit VMS përfshin ndërhyrje në komponentë software dhe hardware, administrimin dhe konfigurimin e sistemeve, bazave të të dhënave dhe infrastrukturës së rrjetit, si dhe trajtimin e incidenteve, procese të cilat kërkojnë zbatimin e masave dhe procedurave të përshtatshme për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

Zbatimi i këtij standardi kontribuon në menaxhimin sistematik të risqeve të sigurisë së informacionit, kontrollin e aksesit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit, duke mbështetur realizimin e sigurt dhe të kontrolluar të shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemit VMS.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë stafin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit, minimalisht si më poshtë:

- a) Të paktën 2 (dy) specialistë të diplomuar në degët: Inxhinieri Elektronike / Inxhinieri Informatike/ Teknologji Informacioni / Informatikë / ose çdo arsim tjetër i ngjashëm.

- b) Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për sistemin Vessel Monitoring System (VMS)/ Themis ose ekuivalent;
- c) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në administrimin dhe konfigurimin e rrjeteve kompjuterike (Network), ose ekuivalent.
- d) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në administrimin e bazave të të dhënave SQL, ose ekuivalent.
- e) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në zhvillimin dhe/ose administrimin e aplikacioneve në teknologjinë Java, ose ekuivalent.

Për punonjësit në pikën a), Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomat përkatëse
- kontratë pune të vlefshme

Për punonjësit në pikën b), c), d), e), Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- kontratë pune të vlefshme
- Certifikatat ose Transkriptet përkatëse, dëshmitë e trajnimit ose dokumentacion tjetër ekuivalent (të vlefshëm), që provon kualifikimin profesional në fushën e kërkuar;

Shënim: Kërkesat për certifikimet/kualifikimet e përcaktuara në pikat b), c), d) dhe e) mund të përmbushen në mënyrë të kombinuar nga punonjësit e kërkuar në këtë kriter. Një punonjës mund të përmbushë një ose më shumë nga këto kërkesa, nëpërmjet paraqitjes së certifikatave ose transkripteve përkatëse, dëshmi të trajnimit ose dokumentacionit tjetër ekuivalent (të vlefshëm), që provon kualifikimin profesional në fushën e kërkuar.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fitesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat për stafin teknik janë përcaktuar në raport me natyrën, arkitekturën dhe shtrirjen e sistemit VMS, si dhe me shërbimet konkrete të mirëmbajtjes të parashikuara në Termat e Referencës.

Referuar Termave të Referencës, objekti i kontratës përfshin mirëmbajtjen e sistemit VMS në të gjithë komponentët e tij, përfshirë sistemin/aplikacionin, infrastrukturën mbështetëse të vendosur në Datacenterin Qeveritar dhe QNOD, si dhe pajisjet MTU të instaluar në anijet e peshkimit. Shërbimi përfshin monitorimin, diagnostikimin dhe izolimin e problematikave, konfigurimin, mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese, administrimin e incidenteve dhe ndërhyrjet në komponentët hardware dhe software, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit.

Për rrjedhojë, kërkesat për personelin janë përcaktuar në funksion të sigurimit të kapaciteteve profesionale dhe kompetencave teknike minimale të nevojshme për mbulimin e komponentëve dhe teknologjive kryesore të sistemit gjatë realizimit të kontratës.

a) Të paktën 2 (dy) specialistë të diplomuar në fushat e kërkuara

Kërkesa për specialistë me arsim të lartë në fushat e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinierisë Informatike, Teknologjisë së Informacionit, Informatikës ose fusha të tjera të ngjashme lidhet me natyrën teknologjike dhe arkitekturën e sistemit VMS.

Sistemi përbëhet nga komponentë të ndryshëm dhe të ndërvarur hardware dhe software, duke përfshirë aplikacionin, serverët, sistemet operative, bazën e të dhënave, infrastrukturën e rrjetit dhe të sigurisë, si dhe pajisjet MTU/transponderët. Për realizimin e shërbimeve të monitorimit, diagnostikimit, konfigurimit, mirëmbajtjes dhe trajtimit të problematikave në një infrastrukturë të tillë kërkohej personel me formim profesional të përshtatshëm në fushën e teknologjisë së informacionit, informatikës dhe elektronikës.

Numri minimal prej 2 (dy) specialistësh është përcaktuar duke marrë në konsideratë shtrirjen e shërbimit në disa komponentë teknikë të sistemit dhe natyrën e ndërhyrjeve të parashikuara në Termat e Referencës. Realizimi i kontratës përfshin njëkohësisht veprimtari të monitorimit dhe kontrollit periodik, diagnostikimit

të problematikave, mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, konfigurimit dhe ndërhyrjeve në komponentë të ndryshëm të infrastrukturës.

Në këto kushte, angazhimi i të paktën dy specialistëve me formim profesional përkatës siguron kapacitetin minimal për ndarjen dhe mbulimin e detyrave teknike sipas komponentëve dhe natyrës së ndërhyrjeve, si dhe mundëson realizimin e veprimtarive të planifikuara të mirëmbajtjes pa cenuar kapacitetin për trajtimin e problematikave që mund të shfaqen gjatë funksionimit të sistemit.

Përcaktimi i këtij numri është bërë në funksion të kapacitetit minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimit dhe nuk synon përcaktimin e një strukture të zgjeruar personeli apo kufizimin e mënyrës së organizimit të stafit nga operatorët ekonomikë.

b) Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për sistemin Vessel Monitoring System (VMS)/THEMIS ose ekuivalent

Kërkesa për specialistë të certifikuar/trajnuar për sistemin VMS/THEMIS lidhet drejtpërdrejt me sistemin konkret objekt mirëmbajtjeje dhe me nevojën që operatori ekonomik të disponojë personel me njohuri specifike mbi funksionimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e tij.

Sipas Termave të Referencës, sistemi VMS mbështetet në aplikacionin THEMIS dhe në një arkitekturë të integruar, ku komponentët software ndërveprojnë me bazën e të dhënave, serverët, infrastrukturën e rrjetit dhe pajisjet MTU të instaluar në anije. Mirëmbajtja e këtij sistemi kërkon njohuri specifike për monitorimin e funksionaliteteve, kontrollin e aktivitetit dhe roleve të përdoruesve, analizimin e log-eve, diagnostikimin dhe izolimin e problematikave, konfigurimin dhe optimizimin e sistemit, si dhe trajtimin e incidenteve.

Numri minimal prej 2 (dy) specialistësh është përcaktuar duke marrë në konsideratë karakterin e vazhdueshëm të funksionimit të VMS dhe shtrirjen e shërbimeve që kërkojnë njohuri specifike mbi këtë sistem. Termat e Referencës parashikojnë si veprimtari të planifikuara të monitorimit dhe mirëmbajtjes, ashtu edhe ndërhyrje korrigjuese dhe trajtimin e problematikave që mund të lindin gjatë operimit të sistemit.

Në këtë kuadër, angazhimi i dy specialistëve mundëson mbulimin e veprimtarive të planifikuara dhe të nevojave për ndërhyrje që mund të lindin gjatë funksionimit të sistemit, si dhe ruajtjen e vazhdimësisë së suportit teknik në përputhje me kërkesat dhe kohët e reagimit të përcaktuara në Termat e Referencës. Një kapacitet i tillë është i nevojshëm veçanërisht duke konsideruar se qëllimi i kontratës është sigurimi i vazhdimësisë së funksionimit të VMS dhe se për komponentë të sistemit parashikohet mirëmbajtje 24x7 dhe reagim brenda afateve të përcaktuara.

Për rrjedhojë, kërkesa për 2 (dy) specialistë është përcaktuar si kapacitet minimal për mbulimin efektiv dhe në vijimësi të kompetencës specifike VMS/THEMIS, pa e kushtëzuar realizimin e shërbimit nga angazhimi i një specialisti të vetëm dhe pa kërkuar një numër më të lartë personeli se sa vlerësohet i nevojshëm për realizimin e kontratës.

c) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në administrimin dhe konfigurimin e rrjeteve kompjuterike (Network), ose ekuivalent

Kërkesa për këtë kompetencë lidhet drejtpërdrejt me arkitekturën e komunikimit të sistemit VMS. Komunikimi ndërmjet stacionit bazë të transmetimeve satelitore dhe serverit realizohet nëpërmjet infrastrukturës së rrjetit dhe firewall-it, ndërsa sistemi mundëson edhe akses të largët nëpërmjet lidhjeve të sigurta.

Infrastruktura fizike e VMS përfshin gjithashtu pajisje aktive të rrjetit, ndër të tjera switch-e dhe firewall, ndërsa shërbimi objekt kontrate përfshin monitorimin e pajisjeve, kontrollin e log-eve, diagnostikimin dhe izolimin e problematikave, konfigurimin dhe ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese.

Për këtë arsye, disponimi i të paktën 1 (një) specialisti me kompetencë të certifikuar në administrimin dhe konfigurimin e rrjeteve është i nevojshëm për diagnostikimin dhe trajtimin e problematikave të komunikimit, konfigurimin e elementeve të rrjetit dhe sigurimin e ndërlidhjes së komponentëve të sistemit gjatë realizimit të shërbimit.

d) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në administrimin e bazave të të dhënave SQL, ose ekuivalent

Kërkesa për këtë kompetencë lidhet drejtpërdrejt me arkitekturën software të sistemit. Sipas Termave të Referencës, sistemi përdor bazën e të dhënave PostgreSQL, të hostuar mbi Linux CentOS, si dhe PostGIS për analizat gjeohapësinore.

Baza e të dhënave përbën një komponent të rëndësishëm për funksionimin e VMS, pasi në të ruhen dhe përpunohen të dhënat e administruara nga sistemi. Arkitektura e aplikacionit përfshin gjithashtu procesimin e mesazheve që vijnë nga ofruesit satelitorë, validimin e strukturës së tyre dhe transformimin në format të përdorshëm nga baza e të dhënave.

Në kushtet kur mirëmbajtja përfshin monitorimin e funksionimit të sistemit, analizimin e problematikave, konfigurimin dhe optimizimin e komponentëve të tij, kërkohet të paktën 1 (një) specialist me kompetencë profesionale të provuar në administrimin e bazave të të dhënave SQL, me qëllim sigurimin e kapacitetit teknik për trajtimin e problematikave që mund të shfaqen në këtë shtresë të sistemit.

e) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në zhvillimin dhe/ose administrimin e aplikacioneve në teknologjinë Java, ose ekuivalent

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me teknologjinë e aplikacionit objekt mirëmbajtjeje. Referuar Termave të Referencës, në backend të sistemit përdoret Oracle Java, ndërsa aplikacioni ekspozohet nëpërmjet Apache Tomcat Web Server. Arkitektura e THEMIS përfshin gjithashtu Web Services, module për procesimin e mesazheve dhe shtresën e logjikës së biznesit.

Për rrjedhojë, mirëmbajtja e komponentit aplikativ kërkon njohuri profesionale në teknologjinë Java për diagnostikimin dhe trajtimin e problematikave në nivel aplikativ, analizimin e funksionimit të komponentëve përkatës dhe realizimin e ndërhyrjeve që lidhen me konfigurimin, mirëmbajtjen dhe optimizimin e aplikacionit.

Përcaktimi i të paktën 1 (një) specialisti synon sigurimin e kompetencës teknike të nevojshme për këtë komponent të sistemit, pa kërkuar një numër të veçantë apo të zgjeruar personeli për këtë fushë.

Mbi përmbushjen e kombinuar të kërkesave të pikave b), c), d) dhe e)

Kërkesat për certifikimet/kualifikimet e përcaktuara në pikat b), c), d) dhe e) janë vendosur në funksion të kompetencave teknike që duhet të mbulohen gjatë realizimit të kontratës dhe jo me qëllim përcaktimin e një numri kumulativ punonjësish për secilën prej tyre.

Për këtë arsye, është parashikuar mundësia që këto kërkesa të përmbushen në mënyrë të kombinuar nga punonjësit e operatorit ekonomik, ku një punonjës mund të përmbushë një ose më shumë prej kërkesave të mësipërme, nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit përkatës provues.

Ky parashikim siguron mbulimin e të gjitha kompetencave teknike të nevojshme për mirëmbajtjen e sistemit VMS, duke i lënë njëkohësisht operatorit ekonomik fleksibilitet në organizimin dhe shpërndarjen e këtyre kompetencave ndërmjet stafit të tij, pa kërkuar në mënyrë të detyrueshme një punonjës të ndryshëm për çdo certifikim/kualifikim.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori/partneri i autorizuar prej tij, ose dokumentacion tjetër ekuivalent, nga i cili të rezultojë se operatori ekonomik ka të drejtën/mbështetjen e nevojshme për sigurimin e shërbimeve të kërkuara, në termat e referencës. Dokumentacioni i dorëzuar duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, kërkesa për autorizim nga prodhuesi, distributori/partneri i autorizuar ose dokumentacion tjetër ekuivalent synon të provojë se operatori ekonomik ka akses në mbështetjen teknike të nevojshme për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemit VMS, sipas kërkesave të përcaktuara në Termat e Referencës.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi, distributori/partneri i autorizuar prej tij ose dokumentacionit tjetër ekuivalent lidhet me natyrën dhe arkitekturën teknike të sistemit VMS, si dhe me shërbimet konkrete të mirëmbajtjes të parashikuara në Termat e Referencës.

Në nivel aplikativ, sistemi mbështetet në platformën THEMIS, e strukturuar në module të specializuara dhe Web Services për shkëmbimin e të dhënave me sisteme të tjera. Për këtë arsye, mirëmbajtja e sistemit kërkon jo vetëm kapacitete të përgjithshme në fushën e teknologjisë së informacionit, por edhe mundësinë për të siguruar mbështetje teknike të specializuar për komponentët përkatës.

Rëndësia e kësaj mbështetjeje lidhet edhe me vijueshmërinë e funksionimit të sistemit. VMS realizon monitorimin dhe gjurmimin e anijeve të peshkimit dhe shkëmben të dhëna me sisteme dhe qendra të tjera, përfshirë EFCA dhe shtetet fqinje. Për komponentë të infrastrukturës Termat e Referencës parashikojnë gjithashtu mirëmbajtje 24x7 dhe kohë reagimi të përcaktuara për ndërhyrjet teknike. Mbështetja nga prodhuesi ose rrjeti i tij i autorizuar është e rëndësishme edhe për administrimin e ciklit të jetës së komponentëve (product lifecycle). Suporti nga prodhuesi / distributori i autorizuar asiston në ndërhyrjet teknike / ‘troubleshooting’ mbi komponentet ‘hardware’ dhe ‘software’, personelin teknik në terren nëpërmjet ndërveprimit ‘remote’ apo udhëzimeve teknike specifike.

Sikurse paraqitur në seksionin e specifikimeve teknike, natyra e sistemit aktual konsiderohet specifike në kompozim dhe zbatim / funksionalitet. Krahas mirëmbajtjes së pajisjeve si servera, ‘switch’, ‘firewall’ etj AK paraqet kërkesën për suport teknik referuar MTU, ri-instalimin dhe konfigurimin e tyre në rast nevojë duke përfshirë dhe licensimet përkatëse mbi sistemin VMS. Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit VMS mbi aplikacionin THEMIS pritet të suportoje shkëmbimin e të dhënave me EFCA, shtetet fqinje nga ku problematikat teknike orientohen në impakte të konsiderueshme.

Gjithashtu specififikimet teknike të paraqitur nga AK mbi mirëmbajtjen e platformës 'hardware' paraqet kërkesën mbi mirëmbajtjen e pajisjeve me ndihmën e vetë prodhuesëve apo distributorëve të autorizuar nga ku për pajisje primare si MTU duhet të disponojë stok të dedikuar.

Kërkesa mbi autorizimin e prodhuesit / distributorit të autorizuar bazohet mbi rëndësinë, kompozimin specifik të shërbimit, infrastrukturën aktuale që paraqet procesi i mirëmbajtjes së sistemit VMS.

Për sa më sipër, kërkesa për autorizim nga prodhuesi, distributori/partneri i autorizuar prej tij ose dokumentacion tjetër ekuivalent nuk synon thjesht të provojë një marrëdhënie tregtare me prodhuesin, por të sigurojë që operatori ekonomik ka mbështetjen teknike të nevojshme për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes, diagnostikimit, konfigurimit, licencimit dhe ndërhyrjeve të tjera të parashikuara në Termat e Referencës.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të realizojë shërbimin objekt prokurimi (sipas përcaktimeve në termat e referencës), duke e lënë sistemin përkatës në kushte të plota optimale pune.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në mbështetje të nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa lidhet me natyrën e shërbimit dhe nevojën për realizimin e tij në përputhje të plotë me Termat e Referencës. Duke qenë se sistemi VMS përbëhet nga komponentë hardware dhe software të ndërlidhur, mirëmbajtja e tij përfshin monitorimin, diagnostikimin, konfigurimin, mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese, si dhe riparimin apo zëvendësimin e komponentëve, sipas nevojës.

Nëpërmjet kësaj deklarate, operatori ekonomik merr përsipër realizimin e plotë të shërbimeve dhe ndërhyrjeve të parashikuara në Termat e Referencës, me qëllim ruajtjen e funksionimit të rregullt të sistemit gjatë periudhës së kontratës dhe lënien e tij, pas kryerjes së shërbimeve përkatëse, në kushte të plota optimale pune.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e referencës janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga ekspert, i kontraktuar nga autoriteti kontraktor "Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit", për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqëndruara" Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise", i ndryshuar.

Në dokumentacion e përcjellë pranë OBP, AK përshkruan:

Qëllimi i kësaj kontrate është mirëmbajtja e sistemit VMS në mënyrë që të sigurohet vazhdueshmëria e punës pa ndërprerje.

Përmes këtij qëllimi do të përfitohet:

- Mosndërprerja e monitorimit dhe dokumentimi i plote i aktivitetit të peshkimit nga autoritetet përkatëse.
- Mosndërprerja e monitorimit dhe dokumentimi i plote i aktivitetit kufitar nga ana e autoriteteve të Ministrisë së Brendshme.
- Mirëmbajtje e pajisjeve fizike (servera, switch, firewall, MTU për të gjitha anijet mbi 12m gjatësi, etj), ri-instalimin dhe konfigurimin e tyre në rast nevojë, duke përfshirë dhe licencimet përkatëse për lidhjen me sistemin VMS, etj.

Objekti kryesor i këtij shërbimi është mirëmbajtja e sistemit VMS, në çdo komponent të tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Komponentët kryesore të kesaj procedure janë:

- i. Sistemi VMS;
- ii. Infrastruktura mbështetëse e tij (Datacenteri Qeveritar, QNOD, etj);
- iii. Pajisjet e montuara neper anije (MTU për të gjitha anijet mbi 12m gjatësi, etj) .

Krahas objektit kryesor të mirembajtjes, nëpërmjet kësaj kontrate shërbimi do të përfitohen edhe optimizime të sistemit dhe siguri i sinjalit satelitor të transmetimit.

SI ËSHTË I NDËRTUAR SISTEMI

Monitorimi i anijeve të peshkimit, realizohet nëpërmjet sistemit të monitorimit të anijeve VMS (Vessel Monitoring System). Sistemi VMS është sistem satelitor i mbyllur që transmeton të dhënat e anijeve të peshkimit çdo dy orë. Sistemi VMS ka përfunduar përmirësimin në vitin 2021 dhe aktualisht ka nevojë që investohet në mirëmbajtje të tij. Në total janë 220 anije peshkimi mbi 12 metra të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Që prej muajit Qershor 2021 të gjitha anijet transmetojnë rregullisht dhe monitorohen nga QNOD dhe institucione të tjera.

Sistemi VMS mbështetet mbi aplikacionin THEMIS (Versioni 8.19.13), i cili është një platformë e shkallëzueshme (scalable) e ndërtuar mbi teknologji "Enterprise" nga CLS Group (Collecte Localisation Satellites), e projektuar për procesimin e të dhënave kritike në kohë reale.

Versioni 8.19.13 i THEMIS është i strukturuar në module të specializuara që komunikojnë përmes një arkitekture të orientuar nga shërbimet (SOA):

- Web Services (API Layer): Sistemi përdor Web Services REST për shkëmbimin e të dhënave me qendrat e tjera ndërkombëtare (p.sh. shkëmbimi i të dhënave me EFCA ose shtetet fqinje). Kjo mundëson integrimin e shpejtë të të dhënave të 220 anijeve me sistemet e tjera ndërqeveritare.
- Moduli i Procesimit të Mesazheve: Ky modul është përgjegjës për dekodimin e mesazheve që vijnë nga ofruesit satelitorë, validimin e strukturës së tyre dhe transformimin në format të lexueshëm për bazën e të dhënave.
- Business Logic Layer: Implementon rregullat specifike të peshkimit, si: llogaritja e kohës në det, hyrje-daljet në zona të ndaluara dhe gjenerimi i alarmeve automatike për operatorët e QNOD.

Frontend i këtij sistemi është GUI i aplikacionit THEMIS versioni 8.9.13 HTML/CSS edhe JavaScript si edhe GIS web Libraries për Vizualizimin e hartës.

Në backend përdoret Oracle Java version 12.2. Ky version siguron performancë të lartë në procesimin e "multithreading" për trajtimin e sinjaleve sinkrone dhe asinkrone që vijnë nga terminalët e anijeve. Ky aplikacion ekspozohet nëpërmjet apache tomcat web server për menaxhimin e kërkesave HTTP/HTTPS.

Ky sistem përdor Databazen PostgreSQL versioni 12.6 i hostuar mbi Linux CentOS si edhe PostGIS për analiza gjeohapsinore.

Përshkrim i Përgjithshëm

Pajisjet qendrore të këtij sistemi ndodhen në Datacenterin Qeveritar, pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Me anë të këtij sistemi kryhet monitorimi dhe gjurmimi i anijeve të peshkimit të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Të gjitha anijet mbi 12m gjatësi kanë detyrim për ta pasur të instaluar sipas ligjit 64/2012 për peshkimin dhe të drejtën për marrjen e të dhënave dhe monitorimin e anijeve të peshkimit e ka vetëm autoriteti përgjegjës për këtë detyrë sipas ligjit (QNOD). Ky sistem është instaluar fillimisht në vitin 2011 si donacion i BE- së por dhe si një nga kushtet për t'u plotësuar nga shteti ynë si pjesë e 5 kritereve për çeljen e negociatave dhe e anëtarësimit nga BE-ja. Ky sistem tashmë është totalisht funksional dhe është përmendur në progres raportin e vitit 2021 dhe 2022 nga Komisioni Europian që Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në këtë sektor veçanërisht me funksionimin e këtij sistemi. (Albania made good progress, specifically on maintaining operational the Vessel Monitoring System (VMS) and allocating human resources to monitor and report on the activity of fishing vessels fq. 116)

QNOD është qendër raportimi dhe informacioni, qendër komandimi dhe kontrolli për operacionet detare, e cila shërben dhe si qendër kombëtare për kërkim-shpëtimin në det.

Institucionet pjesëmarrëse në QNOD, janë:

- Roja Bregdetare (Ministria e Mbrojtjes)
- Policia Kufitare dhe Migracionit (Ministria e Punëve të Brendshme)
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Dogana, Ministria e Financave)
- Drejtoria Përgjithshme Detare (Kapiteneria e Porteve, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës)
- Inspektorati Mjedisit (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)
- Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (Ministria e Bujqësisë, dhe Zhvillimit Rural)
- Agjencia Kombëtare Bregdetit (Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes)

Secili institucion me sipër e akseson sistemin përmes ndërfaqes web, nëpërmjet një adrese <https>. Përdoruesit e sistemit autentifikohen me username dhe password me 9 karaktere (numra dhe germa), i cili ndryshojnë çdo 90 (nëntëdhjetë) dite.

Ne baze të funksionit që gjithsecili ka, ata monitorojnë / investojnë dhe kontrollojnë përputhshmërinë e të dhënave që marrin edhe nga sistemi.

Shembull: Policia kufitare dhe Migracionit verifikon mjete të cilët po investigon dhe ka sinjalizime nga sistemi i radarit.

Sistemi ofron nivele të ndryshme aksesit dhe përdorimi (lexues, operator, hedhes të dhënash, admin)

Për të siguruar mirëfunksionimin e të gjitha operacioneve në det është vënë në dispozicion numri emergjencës – 125 (numri blu).

Funksioni i këtij numri emergjence shpejton ndërhyrjen për shpëtimin e qenieve njerëzore dhe mjeteve detare.

Analiza e Proceseve të Punës

Komunikimi midis stacionit bazë të transmetimeve satelitore dhe serverit realizohet nëpërmjet firewallit dhe shërbimit të internetit.

Sistemi i monitorimit të përhershëm të flotës së peshkimit dhe kontrollit të parametrave punon në nivel lokal me një qendër të dedikuar dhe është e mundur që të sigurohet akses i largët (nëpërmjet lidhjes së sigurtë të internetit) në qendrën kryesore apo qendra të tjera autonome të lidhura së bashku.

Vetëm përdoruesi mund të ketë qasje në të dhënat e llogarisë sipas rolit të secilit institucion.

Me pas inspektorët fillojnë me monitorimin e errësive dhe logeve për secilën anije duke përfunduar në analizimin e dinamikës së lundrimit, zonave të lejuara/ndaluara periodicitetin e dhënies shënies së informacionit, etj.

Në Termat e Referencës gjithashtu janë të sqaruara të gjitha specifikimet teknike, detyrat e ofertuesit gjatë ekzekutimit të kontratës, afatet e realizimit.

Gjithashtu, lidhur me Termat e Referencës AK jep sqarimet si më poshtë:

1. Statusi aktual i licencës: për 230 transponderët (MTU) CLS Triton Advanced është parashikuar licenca "Triton Advanced Base License", me afat 2 (dy)-vjeçar dhe me nevojë për rinovim periodik. Në kuadër të shërbimit të mirëmbajtjes, operatori ekonomik është përgjegjës për licencimin dhe konfigurimin e MTU-ve, me qëllim garantimin e vijimësisë së funksionimit të sistemit VMS. Shërbimi satelitor sigurohet nga CLS France (ofrues CLS/Iridium); marrëveshja përkatëse e shërbimit satelitor nuk disponohet aktualisht nga AKSHI, pasi është lidhur nga kontraktori i mëparshëm.

2. Përditësimi i sistemeve operative dhe i versioneve softuerike në versionet më të fundit: Në kuadër të shërbimit të mirëmbajtjes parashikohen kontrollat e infrastrukturës hardware, riparimi dhe/ose zëvendësimi i pajisjeve me status "failed", si dhe dhënia e rekomandimeve për upgrade të mundshëm hardware. Termat e referencës nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur furnizimin/prokurimin e kapaciteteve të reja si pjesë e këtij shërbimi; në rast nevojë për rritje kapacitetshe ose ndryshime të infrastrukturës, operatori ekonomik do të evidentojë dhe rekomandojë ndërhyrjen përkatëse, e cila do të trajtohet sipas procedurave të veçanta.

3. Veprimtaria "upgrade" mbi kapacitetet hardware: shërbimi i mirëmbajtjes parashikon kontrollin e infrastrukturës hardware dhe riparimin dhe/ose zëvendësimin e pajisjeve me kapacitet ekzistues.

Ndarja në Lote:

Bazuar në nenin 39 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar, argumntojmë si vijon:

Vlerësohet që procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Mirëmbajtje e sistemit VMS për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, të mos ndahet në lote, duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit, integrimin dhe ndërvarësinë teknike e funksionale të komponentëve të sistemit, si dhe kërkesat për realizimin e shërbimeve të përcaktuara në Termat e Referencës.

Sistemi VMS funksionon si një sistem i integruar, i përbërë nga aplikacioni dhe modulet software, baza e të dhënave, serverët dhe sistemet operative, infrastruktura e rrjetit dhe e sigurisë, si dhe pajisjet MTU/transponderët dhe komponentët e tjerë të ndërlidhur me të. Çdo aset/element në këtë infrastrukturë ndërvepron me elementët e tjerë nëpërmjet alternimit funksional. Funksionimi i rregullt i sistemit mbështetet në ndërveprimin dhe përputhshmërinë ndërmjet këtyre komponentëve.

Shërbimet objekt kontrate përfshijnë monitorimin, diagnostikimin, konfigurimin, mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese, administrimin dhe trajtimin e incidenteve, ndërhyrjet në komponentët hardware dhe software, si dhe licencimin/rinovimin e licencave të nevojshme për funksionimin e sistemit.

Në këto kushte, ndarja e kontratës në lote të veçanta sipas komponentëve apo kategorive të shërbimit nuk vlerësohet e përshtatshme, pasi do të fragmentonte përgjegjësinë për mirëmbajtjen e një sistemi të integruar dhe do të kërkonte koordinimin ndërmjet disa kontraktorëve për diagnostikimin dhe zgjidhjen e problematikave që mund të lidhen me më shumë se një komponent të sistemit.

Në veçanti, në rast incidentesh, identifikimi i burimit të problematikës mund të kërkojë verifikimin dhe ndërhyrjen në disa shtresa të sistemit, përfshirë aplikacionin, bazën e të dhënave, sistemet operative, serverët, rrjetin dhe pajisjet e komunikimit. Angazhimi i kontraktorëve të ndryshëm për komponentë të veçantë do të krijonte ndërvarësi në realizimin e shërbimeve dhe mund të sillte vështirësi në koordinimin e ndërhyrjeve dhe përcaktimin e përgjegjësisë, si dhe risk për respektimin e afateve të reagimit dhe ndërhyrjes të përcaktuara në SLA.

Realizimi i shërbimeve nëpërmjet një kontrate të vetme mundëson administrimin e integruar të mirëmbajtjes, koordinimin e ndërhyrjeve dhe përcaktimin e qartë të përgjegjësisë kontraktore për funksionimin e sistemit në tërësi, duke garantuar njëkohësisht vijueshmërinë dhe nivelin e kërkuar të shërbimit.

Për sa më sipër, mosndarja e kontratës në lote vlerësohet e justifikuar nga integriteti teknik dhe funksional i sistemit VMS, ndërvarësia e komponentëve të tij, nevoja për respektimin e niveleve të përcaktuara të shërbimit (SLA), si dhe nevoja për administrim të integruar dhe përgjegjësi të unifikuar kontraktore gjatë realizimit të shërbimit.

Nënkontraktimi

Bazuar në nenin 126 të LPP dhe nenit 89 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar, dispozita të cilat parashikojnë mundësinë e lejit të nënkontraktimit për realizimin e një pjese të kontratës, vlerësohet se: duke marrë në konsideratë natyrën e integruar dhe kritike të sistemit VMS, si dhe nevojën për të garantuar përgjegjësi të drejtpërdrejtë dhe të unifikuar të kontraktorit gjatë gjithë periudhës së realizimit të shërbimit, nënkontraktimi nuk vlerësohet i përshtatshëm, pasi:

Shërbimi objekt kontrate përfshin ndërhyrje të ndërlidhura në komponentët hardware dhe software të sistemit, përfshirë aplikacionin THEMIS, bazën e të dhënave, serverët, infrastrukturën e rrjetit dhe të sigurisë, si dhe pajisjet MTU/transponderët. Gjithashtu, parashikohen monitorimi dhe diagnostikimi i sistemit, trajtimi i incidenteve, konfigurimi, mirëmbajtja parandaluese dhe korrigjuese, si dhe respektimi i niveleve dhe afateve të përcaktuara të shërbimit.

Në këto kushte, përfshirja e subjekteve të tjera në realizimin e shërbimeve kryesore mund të fragmentojë përgjegjësinë teknike dhe operative, veçanërisht në rastet kur diagnostikimi dhe zgjidhja e një problematike kërkon ndërhyrje të koordinuar në disa komponentë të sistemit. Për këtë arsye, është vlerësuar e nevojshme që përgjegjësia për realizimin e shërbimit dhe përmbushjen e kërkesave të Termave të Referencës të qendrojë drejtpërdrejt te kontraktori.